

Monitoruesi i Korrupsionit

Raport mbi Monitorimin e Aktiviteteve Institucionale në Luftë
Kundër Korrupsionit
Korrik-Gusht 2011



British Embassy
Pristina

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	3
Hyrje	4
Qeveria e Kosovës	5
Kuvendi i Kosovës	6
Sistemi Gjyqësor	8
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	8
Policia e Kosovës	9
Doganat e Kosovës	10
Falënderime	11
Rreth Lëvizjes FOL	11

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

AKK - Agjencia Kundër Korrupsionit

BFCO - British Foreign & Commonwealth Office

DHKEK - Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

DG - Doganat e Kosovës

EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

KGJK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës

LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës

PDK - Partia Demokratike e Kosovës

PK - Policia e Kosovës

VV - Lëvizja Vetëvendosje!

Përmbledhje Ekzekutive

Qeveria e Kosovës gjatë dy muajve (korrik-gusht) ka miratuar gjithsej 88 (tetëdhjetetë) vendime: 51 vendime në muajin korrik, ndërkaq 37 sosh në muajin gusht. Derisa në muajin korrik janë nxjerrë vetëm 3 vendime kundër korrupsionit, muaji gusht ka qenë edhe më keq: me vetëm 1 vendim. Në kuadër të këtyre vendimeve hyjnë miratimi i projekt-ligjit për Parandalim të Konfliktit të Interesit, ai për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë, ai për Mbrojtjen e Informatorëve, si dhe ai për Financimin e Subjekteve Politike;

Kuvendi i Kosovës gjatë dy muajve (korrik dhe gusht) ka mbajtur gjithsej 8 seanca plenare: 2 seanca të jashtëzakonshme dhe 6 sosh të rregullta. Prej tyre 7 janë mbajtur në muajin korrik dhe vetëm 1 në muajin gusht. Në seancat plenare të muajit korrik janë shqyrtuar projekt-ligjet për Mbrojtjen e Informatorëve; Prokurimin Publik; Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë; Parandalimin e Konfliktit të Interesit si dhe ai për Financimin e Subjekteve Politike;

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është treguar shumë pak produktiv. Në kuadër të kategorisë “shpërdorim i detyrës zyrtare” 122 lëndë kanë qenë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, 1 lëndë është pranuar në punë, 1 lëndë kanë në proces të shqyrtimit, vetëm 2 lëndë janë zgjidhur, ndërkaq 121 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura. Në kuadër të kategorisë “marrje e ryshfetit” kemi 20 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, asnjë lëndë të pranuar në punë, 30 lëndë në proces të shqyrtimit, asnjë lëndë të zgjidhur dhe 30 sosh të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. Ndërkaq në kuadër të kategorisë “dhënie e ryshfetit” kemi 14 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, 2 lëndë të pranuar në punë, 16 lëndë në proces të shqyrtimit, vetëm një lëndë të zgjidhur dhe 15 lëndë të tjera të pazgjidhura;

Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK) rezulton se në muajt korrik-gusht janë zhvilluar gjithsej 277 hetime: 151 raste në muajin korrik dhe 126 në muajin gusht. Prej këtyre hetimeve 11 zyrtarë kanë përfunduar të arrestuar: 3 në muajin korrik dhe 8 në muajin gusht. Gjithashtu, janë dërguar gjithsej 142 lëndë në Prokurori: 73 raste në muajin korrik dhe 69 raste të tjera në muajin gusht. Në kuadër të këtyre lëndëve 87 raste janë dërguar në prokurori me kryerës të njohur, 5 raste me kryerës N/N. Ndërkaq, në kuadër të rasteve të dërguara me raport të prokurorit janë gjithsej 50 raste: 21 raste të dërguara në muajin korrik dhe 29 raste në muajin gusht. Ndërkaq vlera e dëmeve të supozuara përllogaritet të jetë 1,226,300.00 €: 666,313.00 € në muajin korrik dhe 559.987.00 € në muajin gusht;

Doganat e Kosovës gjatë dy muajve kanë shqiptuar gjithsej 6 masa disiplinore. Në kuadër të tyre 6 kanë qenë në muajin korrik dhe asnjë lëndë e vetme në muajin gusht. Në kuadër të këtyre masave disiplinore 2 raste janë vërejtje me shkrim, 2 raste ndalim promovimi, 1 rekomandim për mos vazhdim të kontratës së punës, dhe 1 rast tjetër tjetër transfer në detyrë tjetër. Ndërkaq në kuadër të Sektorit për Standarde Profesionale janë paraqitur gjithsej 2 raste: 1 rast në muajin korrik për sjellje jo-profesionale dhe 1 rast tjetër në muajin qershor për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Hyrje

Niveli i lartë i korrupsionit¹ dhe shtrirja e gjerë e tij në instancat më të larta dhe më të ulëta qeverisëse përbën rrezikun kryesor për proceset e shtet-ndërtimit², zhvillimin ekonomik³, transicionin demokratik⁴ dhe qeverisjen cilësore⁵. Ky konstatim pranohet gjerësisht nga segmente të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Të gjithë pajtohen se korrupsioni jo vetëm që është duke i dëmtuar interesat e qytetarëve të Kosovës, por edhe procesin e integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian.⁶ Niveli i lartë i korrupsionit dhe krimit të organizuar ka alarmuar edhe deputetët e Bundestagu-t gjerman. Disa nga ata kanë pohuar që “paratë e qytetarëve gjermanë po investohen në vila private të politikanëve kosovare”.⁷ Në këtë linjë janë edhe raportet e shumta prestigjioze ndërkombëtare. Ato kanë pasqyruar një shkallë të lartë të korrupsionit, krimit të organizuar dhe ekonomisë informale.

1 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës sanksionon 13 lloje të veprave korruptive: shpërdorim të detyrës zyrtare ose autorizimit, përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës, mashtrim në detyrë, përdorim i paautorizuar i pasurisë, marrja e ryshfetit, dhënia e ryshfetit, ushtrim i ndikimit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, zbulim i fshehtësive zyrtare, falsifikim i dokumenteve zyrtare, arkëtim dhe pagesa e paligjshme, lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria, përvetësim i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor

2 Kjo tezë është rezultat i observimeve empirike, pasi që niveli i lartë i korrupsionit po e dëmton seriozisht legjitimitetin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar të Kosovës

3 Më shumë rreth efekteve negative dhe të dëmshme të Korrupsionit shih <http://www.oecd.org> dhe website-n dhe Raportet e Transparency International: <http://www.transparency.org>

4 James B. JACOBS: Korrupsioni dhe Demokracia, Kappa Phi Journal, Volumi 84, 2004, fq. 21

5 United States Agency for International Development (USAID) - Të luftosh korrupsionin: <http://www.usaid.gov/our-work/democracy-and-governance/technical-areas/anti-corruption/>

6 Renzo DAVIDDI: Korrupsioni po e dëmton procesin e integritetit të Kosovës në BE, Koha Ditore, 11 qershor, 2010, fq. 6

7 Florian HAHN, Botuar në Koha Ditore: Deputetët gjermanë akuzojnë Qeverinë e Kosovës për krim dhe korrupsion, 11 qershor, 2010, fq. 4


Bazuar në të gjeturat e tyre Kosova renditet krahas shteteve më të korruptuara në botë dhe përkrah shteteve të dështuara. Derisa bartësit institucionalë kanë premtuar se do ta luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar, opozita ka shprehur kritikën, akuzat dhe mosbesimin e saj. Në këtë kontekst, duke parë me shqetësim të madh këtë fenomen endemik, Lëvizja FOL, me përkrahje të British Foreign & Commonwealth Office, është duke e realizuar projektin e saj ‘Monitoruesi i Korrupsionit’. Përmes këtij projekti FOL mëton të nxjerrë në shesh (mos)punën e institucioneve karshi korrupsionit, duke ndikuar që kjo luftë të jetë në krye-agjendën e të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës”.⁸ FOL konsideron se lufta ndaj korrupsionit duhet të kalojë nga sfera e retorikës në atë të veprimeve konkrete, qasjes serioze dhe rezultateve të prekshme. Kjo është rruga e vetme që Kosova ta përmirësojë legjitimitetin e saj të brendshëm dhe ndërkombëtar. Ta etablojë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe të jetë e krahasueshme me shtetet perëndimore dhe shoqëritë e lira.

8 Hasan PRETENI - Edicioni i Lajmeve (19:30), RTK, 6 qershor, 2010

Qeveria e Kosovës

Qeveria e Kosovës gjatë dy muajve (korrik-gusht) ka miratuar gjithsej 88 (tetëdhjetetë) vendime: 51 vendime në muajin korrik, ndërkaq 37 sosh në muajin gusht. Derisa në muajin korrik janë nxjerrë vetëm 3 vendime kundër korrupsionit, muaji gusht ka qenë edhe më keq: me vetëm 1 vendim. Në kuadër të këtyre vendimeve hyjnë miratimi i projekt-ligjit për Parandalim të Konfliktit të Interesit, ai për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë, ai për Mbrojtjen e Informatorëve⁹, si dhe ai për Financimin e Subjekteve Politike. Ndryshimi i këtyre ligjeve ka qenë rezultat i zbrazëtirave të shumta ligjore - të cilat janë evidentuar nga shoqëria civile, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe mekanizmat e shumtë ndërkombëtarë. Megjithatë, ndryshimet e bëra nuk janë ende në përputhje me rregullat, standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Madje, sipas strategjisë legjislative të qeverisë¹⁰ projekt-ligjet e tilla është dashur të procedohen me herët në Kuvendin e Kosovës. Nëse i analizojmë afatat kohore të kësaj strategjie vërejmë se projekt-

ligji për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë është dashur të miratohet në muajin maj, ndërkaq qeveria e ka miratuar atë në muajin korrik.¹¹ Po ashtu, projekt-ligji për Parandalim të Konfliktit të Interesit është dashur të miratohet në muajin maj, ndërkaq është miratuar në muajin korrik.¹² Më keq sesa këto dy projekt-ligje është ai për Mbrojtjen e Informatorëve, i cili është dashur të miratohet qysh në muajin mars, por që është miratuar vetëm në fund të muajit korrik. Megjithëse projekt-ligji për Financimin e Subjekteve Politike është miratuar sipas



kërkesave kohore të strategjisë, ai prapëseprapë nuk është në përputhje me praktikat ndërkombëtare, duke u lënë hapësirë bizneseve dhe partive politike të implikohen në afera të mundshme korruptive.

⁹ Ky projekt-ligj sipas mendimit tonë është emërtuar gabimisht, pasi që emërtimi "informator" asocion me shumë pjesëtarët e shërbimeve sekrete. Në këtë kuptim, ne kemi propozuar që ky projekt-ligj të quhet Mbrojtja e Raportuesve.

¹⁰ Qeveria e Kosovës: Strategjia Legjislative 2011, miratuar me vendimin nr. 02/05 (16 qershor 2011); e plotësuar me vendimet nr. 03/16, nr. 04/16 dhe nr. 07/32 (10 korrik, 2011). Me gjerësisht shih http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Legjislative_2011-finale-_e_plotësuar_me_10.08.2011.pdf

¹¹ Me hollësisht shih http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_23-te_te_Qeverise_2011.pdf

¹² Po aty, fq. 1

Kuvendi i Kosovës

Kuvendi i Kosovës gjatë dy muajve (korrik dhe gusht) ka mbajtur gjithsej 8 seanca plenare: 2 seanca të jashtëzakonshme dhe 6 sosh të rregullta. Prej tyre 7 janë mbajtur në muajin korrik dhe vetëm 1 në muajin gusht. Në seancat plenare të muajit korrik janë shqyrtuar projekt-ligjet për:

- Mbrojtjen e Informatorëve;
- Prokurimin Publik;
- Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë;
- Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- Financimin e Subjekteve Politike

Në seancën e 28 korrikut është shqyrtuar në lexim të parë projekt-ligji për mbrojtjen e informatorëve, i cili parasheh se zyrtarët që raportojnë për afera të ndryshme korruptive nuk do të ndëshkohen nga eprorët e tyre që janë në pozita më të larta publiko-politike. Sipas zv. kryeministrit Kuçi ky projekt-ligj “do të ketë rol preventiv dhe mënjanues ndaj korrupsionit”. Ndërkaq, partia e dytë në Kuvend LDK ka dhënë vërejtjet dhe rekomandimet e saj. Sipas deputetit të kësaj partie, Haki Demolli, vetë emërtimi dhe përmbajtja janë të gabuara. Më tutje ai ka argumentuar se në “asnjë dispozitë të këtij projekt-ligji nuk rregullohen kushtet për mbrojtje, procedurat dhe mjetet, masat dhe ndëshkimet eventuale për institucionet që nuk ofrojnë mbrojtje për raportuesit e aferave korruptive”.¹³

¹³ Transkripti i mbledhjes plenare të Kuvendit, 28 korrik, 2011, fq. 36. Me gjerësisht shih <http://www.assembly->

Megjithatë, në shqyrtimin e dytë deputeti i PDK-së, Nait Hasani, ka pohuar se i “tërë ligji është i papajtueshëm”, duke nxjerrë në pah ngjashmëritë ndërmjet spiunit dhe informatorit. Ndërkaq, deputeti nga radhët e AAK-së, Ardian Gjini, ka pohuar se ky projekt-ligj “ka të bëjë me sundimin e ligjit dhe jo me spiunllëkun”.¹⁴ Me 54 vota pro, 2 kundër dhe 2 abstenime Kuvendi ka miratuar projekt-ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve. Në seancën e 28 korrikut është shqyrtuar edhe projekt-ligji për Prokurimin Publik. Me këtë projekt-ligj sigurohet integriteti dhe përgjegjësia e zyrtarëve të lartë publikë, nëpunësve civilë dhe personave tjerë që janë të përfshirë në aktivitete prokurimi. Po ashtu, përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës për prokurim publik kontratat me vlerë të mesme dhe të mëdha do të nënshkruhen edhe nga ministrat gjegjës. Një rekomandim të tillë e ka dhënë në vazhdimësi Komisioni Evropian, por edhe shoqëria civile - në mënyrë që të ndikohet në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike në fushën e prokurimit publik. Mirëpo, Lidhja Demokratike e Kosovës ka evidentuar dobësi të shumta të këtij projekt-ligji: duke filluar nga mundësia që kanë në dispozicion (krye)ministri që t’i mbajnë të fshehura çmimet e kontratave të nënshkruara, çështja e afateve të kontratave, mundësitë që ministrat kanë për t’i manipuluar tenderët, etj. Megjithatë, pavarësisht

[koso-va.org/common/docs/proc/trans_s_2011_07_28_10_al.pdf](http://www.assembly-koso-va.org/common/docs/proc/trans_s_2011_07_28_10_al.pdf)


¹⁴ Transkripti i mbledhjes plenare të Kuvendit, 29 korrik, 2011, fq. 44-45. Me hollësisht shih http://www.assembly-koso-va.org/common/docs/proc/trans_s_2011_07_29_10_al.pdf

vërejtjeve të bëra nga ana e disa deputetëve Kuvendi ka miratuar në parim këtë projekt-ligj.¹⁵ Po ashtu, Kuvendi e ka shqyrtuar edhe projekt-ligjin tjetër për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë. Derisa grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka përkrahur në tërësi, deputetët e partive opozitare (LDK, VV dhe AAK) kanë ngritur vërejtje dhe rekomandime të shumta. Deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka theksuar se projekt-ligji i propozuar është në kolizion me atë paraprak. Ndërkaq, deputetja nga radhët e VV, Albulena Haxhiu, ka pohuar se duhet të ndërhyhet tek përkufizimi i anëtarëve të familjeve të zyrtarëve të lartë publikë, në mënyrë që të shtohen babai, nëna, motra dhe vëllai. Gjithashtu, “masat ndëshkimore janë të pamjaftueshme dhe stimulojnë edhe më tutje korrupsionin, duke mos specifikuar shkarkimin e zyrtarëve”. Ngjashmërisht edhe deputetja e AAK-së, Donika Kada-Bujupi, ka pohuar se këtë projekt-ligj e karakterizojnë mangësi të shumta, veçanërisht në aspektin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë. Nga 67 deputetë të pranishëm 65 kanë votuar pro, asnjë kundër dhe vetëm 1 abstenim.

Gjatë kësaj seance plenare është shqyrtuar edhe projekt-ligji tjetër për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Ky projekt-ligj përcakton rregullat e detyrueshme për zyrtarët e lartë publikë

, të cilët gjatë ushtrimit të funksionit publik të parandalojnë konfliktin e mundshëm të interesit ndërmjet interesit publik dhe atij privat. Pjesa më e rëndësishme e projekt-ligjit të ri është zbritja e vlerës së kapitalit nga 20% në 5% për zyrtarët të cilët kanë aksione në ndonjë kompani apo ndërmarrje. Derisa grupi parlamentar i PDK-së e ka përkrahur në parim, deputeti i LDK-së, Haki Demolli, ka ngritur disa mangësi që janë në kuadër të këtij ligji. Ngjashëm ka vepruar edhe deputetja tjetër e VV, e cila ka shprehur pakënaqësinë me procedurat sesi po kalon ky ligj tejet i rëndësishëm për luftimin e korrupsionit. Megjithatë, projekt-ligji në fjalë është miratuar me 64 vota pro, asnjë kundër dhe 3 abstenime.¹⁶ Pritet në muajt në vijim që të miratohet përfundimisht ky projekt-ligj dhe në këtë mënyrë t'i shtohet listës së ligjeve anti-korrupsion.

Seancat Plenare të Kuvendit të Kosovës: Shqyrtimi i projekt-ligjeve anti-korrupsion



¹⁵ 57 vota kanë qenë pro, 1 kundër dhe 1 abstenim

¹⁶ Me hollësisht shih Transkriptin e Kuvendit të Kosovës http://www.assembly-kosova.org/common/docs/proc/trans_s_2011_07_29_10_al.pdf


Sistemi Gjyqësor

Njëra ndër pushtetet më të rëndësishme në kuadër të cilitdo sistem politik është pushteti gjyqësor. Ky pushtet, nëse është i paanshëm dhe i pavarur, apriori parandalon dhe kufizon çdo lloj mundësie për shpërdorim të parasë publike apo për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Njëra nga arsyet pse korrupsioni dhe krimi i organizuar është shtrirë gjithandej institucioneve është edhe zhytja e vet sistemit gjyqësor në korrupsion pikërisht rënia e tij në grackën e presioneve dhe interferimeve politike. Një konstatim të tillë e konfirmon edhe Raporti i fundit i EULEX-it, i cili thekson se sistemi i drejtësisë në Kosovë ende tregon shenja të dobësisë. Më tutje thuhet se interferencat në nivele të ndryshme dhe në forma të llojlojta janë evidentuar.¹⁷ Gjyqësori i Kosovës vazhdon të jetë institucioni që qytetarët janë më së paku të kënaqur. Edhe Raporti i Paralajmërimit të Hershëm kishte regjistruar një rënie prej 10% që shënon nivelin më të ulët të regjistruar ndonjëherë.¹⁸ Prandaj, meqë demokracitë assesi nuk mund të funksionojnë pa sistemin gjyqësor, ngase garanton dhe kontrollon pushtetet tjera, atëherë edhe Kosova het të ndërmarrë hapa të shpejtë dhe seriozë për reformimin e thellë të saj.

¹⁷ Program Raporti 2010: Ndërtimi i Përbashkët i Ndryshimit të Qëndrueshëm, EULEX, qershor 2010, fq. 9


¹⁸ Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, UNDP Kosovë, 27 mars, 2010, fq. 2

Këshilli Gjyqësor i Kosovës - përbëhet nga 13 anëtarë, dhe siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale dhe të paanshme.¹⁹ Bazuar në statistikat e këtij institucioni për muajin korrik shohim se në kuadër të kategorisë “shpërdorim i detyrës zyrtare” 122 lëndë kanë qenë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, 1 lëndë është pranuar në punë, 1 lëndë kanë në process të shqyrtimit, vetëm 2 lëndë janë zgjidhur, ndërkaq 121 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura.




Në kuadër të kategorisë “marrje e ryshfetit” kemi 20 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, asnjë lëndë të pranuar në punë, 30 lëndë në proces të shqyrtimit, asnjë lëndë të zgjidhur dhe 30 sosh të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese.

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës: Neni 108, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 15 qershor, 2008, fq. 42



Ndërkaq në kuadër të kategorisë “dhënie e ryshfetit” kemi 14 lëndë të pazgjidhura në fillim të periudhës raportuese, 2 lëndë të pranuar në punë, 16 lëndë në proces të shqyrtimit, vetëm një lëndë të zgjidhur dhe 15 lëndë të tjera të pazgjidhura.





Policia e Kosovës

Policia e Kosovës perceptohet nga qytetarët e Kosovës si institucioni më i besueshëm dhe më pak i korruptuar në vend. Raporti i EULEX-it ka treguar një shkallë progresioni të Policisë së Kosovës në relacion me kundërvënien ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar²⁰.

Sipas statistikave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK) rezulton se në muajt korrik-gusht janë zhvilluar gjithsej 277 hetime: 151 raste në muajin korrik dhe 126 në muajin gusht. Prej këtyre hetimeve 11 zyrtarë kanë përfunduar të arrestuar: 3 në muajin korrik dhe 8 në muajin gusht.



²⁰ Program Raporti 2010: Ndërtimi i Përbashkët i Ndryshimit të Qëndrueshëm, EULEX, qershor 2010, fq. 13-23



Gjatë këtij intervali kohor sipas statistikave të Policisë janë dërguar gjithsej 142 lëndë në Prokurori: 73 raste në muajin korrik dhe 69 raste të tjera në muajin gusht. Në kuadër të këtyre lëndëve 87 raste janë dërguar në prokurori me kryerës të njohur, 5 raste me kryerës N/N. Ndërkaq, në kuadër të rasteve të dërguara me raport të prokurorit janë gjithsej 50 raste: 21 raste të dërguara në muajin korrik dhe 29 raste në muajin gusht.


Doganat e Kosovës

Doganat e Kosovës gjatë dy muajve kanë shqiptuar gjithsej 6 masa disiplinore. Në kuadër të tyre 6 kanë qenë në muajin korrik dhe asnjë lëndë e vetme në muajin gusht. Në kuadër të këtyre masave disiplinore 2 raste janë vërejtje me shkrim, 2 raste ndalim promovimi, 1 rekomandim për mos vazhdim të kontratës së punës, dhe 1 rast tjetër transfer në detyrë tjetër.



Ndërkaq vlera e dëmeve të supozuara përllëgaritet të jetë 1,226,300.00 €: 666,313.00 € në muajin korrik dhe 559.987.00 € në muajin gusht.

Ndërkaq në kuadër të Sektorit për Standarde Profesionale janë paraqitur gjithsej 2 raste: 1 rast në muajin korrik për sjellje jo-profesionale dhe 1 rast tjetër në muajin qershor për keqpërdorim të detyrës zyrtare.



Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga British Foreign & Commonwealth Office. Ky Raport është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë webfaqe: www.monikorr.org

Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhencës dhe përgjegjësisë institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

Kontakt:

Andrea Gropa 35, 100000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Mob: +377 (0) 44 131 542
Ueb: levizjafol.org
E-mail: info@levizjafol.org